



Pranuar / Dorezuar Punëtor/Prodator Received/Delivered	13-07-2023	3	viti god year
Organ / Shënia Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot Br Prot Prot No	Shtet / Prilog Appendix	Sasia Kohëzina Quantity
SKPM/SHCK	5182	2023	113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.808/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani Kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.808/2023 të datës 02.06.2023 të parashtruar nga ankuesja _____ adresa _____

kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “Kompensim Material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 13.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.808/2023 e datës 02.06.2023 e parashtruar nga ankuesja _____

A r s y e t i m

Nëpunësja civile _____ e punësuar në pozitën e punës “Zyrtare Personeli” në Qendrën e Korrektuese në Lipjan në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 02.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me realizimin e të drejtës së një page jubilarë, me pretendimin ankimor se në muajin Dhjetor 2022 stafit të cilët kanë mbushur njëzetë vite (20) përvojë pune i është bërë pagesa ndërsa ankueses nuk i është bërë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.06.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 12.06.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me numër protokolli 4578/2023 të datës 02.06.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga G.K. për ankesa.kmpshck@rks-gov.net i datës 02.06.2023; Njoftim për ndryshimin e postit e G.M. i datës 04.12.2002; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 09.06.2023; Përgjigje në ankesë e datës 12.06.2023; E-mail nga C.Z. për A.K. i datës 09.06.2023; E-mail nga M.S. për C.Z. i datës 12.06.2023; Shkresat e lëndës me numër 823 i datës 12.06.2023; Akt Emërim i G.M.K. i datës 19.10.2017; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 17.08.2020; Lista e pagave e datës 01.04.2023-30.04.2023; Lista e pagave e datës 01.12.2022-31.12.2022; Vërtetim për G.K. me numër 145 i datës 12.06.2023; E-mail nga M.S. për C.Z. i datës 03.07.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankueses, *është e palejuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Akt Emërimin e datës 19.10.2017 është konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "Zyrtare Personeli" në Qendrën Korrektuese në Lipjan në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Me datë 02.06.2023 ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se në muajin Dhjetor 2022 stafit të cilët kanë mbushur njëzetë vite (20) përvojë pune i është bërë pagesa ndërsa ankueses nuk i është bërë e njëjta kërkon që të ketë barazi transparencë për të gjithë duke respektuar ligjet dhe parimet e barabarta për të gjithë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e lëndës respektivisht përgjigjen përmes e-mailit të datës 03.07.2023 të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës ka konstatuar se ankuesja për njohjen e të drejtës për kompensimin e një page jubilarë me rastin e përmbushjes së njëzet vite (20) përvojë pune në Shërbimin Korrektues të Kosovës, nuk i është drejtuar paraprakisht me kërkesë udhëheqësit më të lartë administrativ si organ kompetent për trajtimin e kësaj çështje në kuadër të organit të punësimit, kështu që lidhur me këtë objekt të ankesës nuk kemi veprim apo mosveprim nga udhëheqësi më i lartë administrativ në raport me të drejtën e pretenduar në ankesë, për çka ankuesja mund të kontestonte ligjshmërinë e veprimit të organit të punësimit, apo mosveprimin e tij, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 124 ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim.*



Çështja e parashtrimit të ankesës kundër vendimit të organit të punësimit është e përcaktuar edhe me nenin 16 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, meqenëse ankuesja në këtë procedurë nuk ka parashtruar fillimisht kërkesë të udhëheqësi më i lartë administrativ i cili konsiderohet punëdhënës i ankueses, Kolegji vlerëson se nuk janë përmbushur kushtet për pranueshmëri të ankesës, siç përcaktohet me nenin 129 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Kështu që duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.808/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

